



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 07.08.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “VED GROUP” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve”, Nr. i prokurimit- 632-26-5571-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-038-511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “VED GROUP” SH.P.K., e dt.07.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve” Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 10.07.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. VËRTETOHET** dosja e tenderit dhe njoftimi për kontratë, e publikuar me datë: 10.07.2026;
- 3.** Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit, ashtu që Dosja e Tenderit mbetet në fuqi pa ndryshime.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik “VED GROUP” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve”, Nr. i prokurimit- 632-26-5571-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-038-511, .

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 13.08.2026, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka konstatuar se:

• PRETENDIMI NR. 1

Sa i përket pajisjes *Kamionë me konstruksion kiper me peshë totale maksimum 1t*, refuzohet si i pabazuar.

Kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit për *"kamionë me konstruksion kiper me peshë totale maksimum 1 ton"* është vendosur me qëllim të përcaktimit të kapacitetit të nevojshëm operacional për realizimin e kontratës dhe është në përputhje me nevojat e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se operatorët ekonomikë e kanë të qartë natyrën e mjetit të kërkuar dhe qëllimin e kësaj kërkesë, respektivisht disponimin e një mjeti me konstruksion kiper i cili është i përshtatshëm për transportimin e ngarkesave deri në 1 ton. Përdorimi i termiit "kamion" në këtë rast është përdorur në kuptimin e përgjithshëm praktik dhe jo si referencë ndaj kategorizimit administrativ të mjeteve sipas legjislacionit të trafikut rrugor.

Gjithashtu, kërkesa nuk është diskriminuese dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi në treg ekzistojnë mjete të ndryshme me konstruksion kiper dhe kapacitet bartës afërsisht 1 ton, të cilat mund të përdoren për realizimin e kontratës.

Për më tepër, pretenduesi nuk ka dëshmuar se kërkesa e kontestuar e pamundëson pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë ose se krijon avantazh të padrejtë për ndonjë operator të caktuar.

• **PRETENDIMI NR. 2**

Sa i përket pajisjes *Gjysmë-rimorkio kiper me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5 t*, refuzohet si i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit për *"Gjysmë-rimorkio kiper me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5 t"* është përcaktuar në përputhje me nevojat reale dhe objektin e kontratës, si dhe me kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Pretendimi se specifikimi është konfuz apo kufizues vetëm për faktin se është kërkuar një gjysmë-rimorkio kiper me kran nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë karakteristikat teknike të mjetit që i nevojitet për realizimin e qëllimit të kontratës, për sa kohë që këto kërkesa lidhen drejtpërdrejt me nevojat dhe objektin e prokurimit.

Sa i përket pretendimit për mungesën e kokës tërheqëse, Autoriteti Kontraktues sqaron se kjo nuk e bën kërkesën të paqartë. Nëse në kuadër të kontratës kërkohet një gjysmë-rimorkio, mënyra e sigurimit dhe përdorimit të saj mund të realizohet në përputhje me konfigurimin dhe kapacitetin teknik të kërkuar. Për më tepër, operatorët ekonomikë kanë mundësi të ofrojnë zgjidhjen teknike që përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Gjithashtu, kërkesa për peshë totale maksimale 3.5 ton, si dhe për pajisjen me konstruksion kiper, kran dhe sinjalizues të punimeve, është përcaktuar për të garantuar që mjeti i ofertuar të jetë i përshtatshëm për përdorimin dhe punët për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë. Këto kërkesa nuk janë vendosur për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar, por për të siguruar kapacitetin dhe funksionalitetin e nevojshëm të mjetit.

Në këtë kuptim, fakti që një operator ekonomik mund të ketë në dispozicion një mjet tjetër, si kamion me konstruksion kiper dhe kran, nuk nënkupton domosdoshmërisht se ai mjet është teknikisht dhe funksionalisht i njëjtë me mjetin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Ekuivalenca duhet të vlerësohet në raport me të gjitha karakteristikat dhe kapacitetet e kërkuara, dhe jo vetëm në bazë të funksionit të përgjithshëm të mjetit.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues konsideron se pretendimet e juaja nuk paraqesin argumente të mjaftueshme për ndryshimin e kërkesave teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe si të tilla, Pretendimet REFUZOHEN si të pabazuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Të gjitha palëve të interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi